



**PROCESVERBAL I DEBATIT PUBLIK  
NË LIDHJE ME KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE  
(KAB) 2025-2027 – HANI I ELEZIT**

Procesverbali nga Debati i parë publik në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025 - 2027 u zhvillua me datën **13.06.2024** duke filluar nga ora 11:00 në Sallën e Konferencavete Qendra e Kulturës “Imri Curri” në Han të Elezit, në të cilin ishin gjithsej 43 pjesëmarrës, prej të cilëve 14 ishin gra dhe 29 burra.

Debatin publik nga Zyra e Kryetarit të Komunës e kryesoi Drejtorja për Buxhet dhe Financa – Lindita Ballazhi e cila i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen e tyre, ndërkaq morën pjesë edhe drejtor e drejtore nga ekzekutivi i Komunës, ku për rend të ditës kishin:

- 1. Prezentimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027**
- 2. Diskutimi i hapur**

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 e prezantoi Drejtorja për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**.

**1. Prezentimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore**

**Lindita Ballazhi:** Duke u bazuar në Ligjin për Financa Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Kosovës gjatë muajit maj të këtij viti ka aprovuar Kornizën Afatmesme të shpenzimeve qeveritare apo KASH-in për periudhën 2025-2027, ku në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve qeveritare lëshoet Qarkorja e parë buxhetore dhe me kufijtë fillestarë në nivel të Kosovës. Me pranimin e Qarkores së parë buxhetore, kemi kufijtë fillestarë buxhetore me të cilat ne bëjmë planifikimin e buxhetit për vitin vijues apo konkretisht për vitin 2025, si dhe parashikimet e hershme për vitin 2026-2027, me ç’rast ne bëjmë hartimin e shpenzimeve duke renditur prioritete kryesore komunale dhe normalisht objektivat të cilat janë të identifikuar në dokumente strategjike komunale. Fazat për zhvillimin e KAB-it komunal dhe afatet kohore janë: në maj Pranimi i Qarkores fillestare Buxhetore 01/2025, Draftimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027, në qershor Konsultimet me Asamblenë Komunale, Mbajtja e Debateve Buxhetore dhe Aprovimi i KAB-it në KPF dhe Kuvend Komunal deri me 30 qershor, në gusht Pranimi i Qarkores Buxhetore 02/2025 dhe Mbajtja e Debateve Buxhetore dhe në shtator Miratimi i Buxhetit Vjetor në Kuvend deri me 30 shtator, më pas Buxheti i miratuar nga Kuvendi dorëzohet në Ministrinë e Punëve dhe Transfereve,

gjegjësisht në Departamentin e Buxhetit. Burimet e financimit komunal përfshijnë: Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik për Arsim, Granti Specifik për Shëndetësi dhe Projektionet e Të Hyrave Vetanake nga Komunitat.

Për vitin buxhetor 2025 Buxheti i Komunitës do të jetë 3,615,457.00 €, këtu kemi përfshirje të 4 burimeve të financimit: nga Granti i Përgjithshëm me pjesëmarrje prej 1,701,892.00 € apo 47.07%, nga Granti Specifik i Arsimit me pjesëmarrje 1,167,634.00 € apo 32.29%, nga Granti Specifik i Shëndetësisë me pjesëmarrje 406,212.00 € apo 11.23% , nga të Hyrat Vetanake Komunitare me pjesëmarrje prej 339,719.00 € apo 9.39%, totali (Grantet + THVK) me pjesëmarrje prej 3,615,457.00 € apo 100.00 %. Në tabelat e paraqitura në KAB gjeni edhe Planin afatmesëm të të hyrave të buxhetit komunal për vitet 2025-2027, Planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2025, si dhe Listën e Projekteve Kapitale, Ndërkaq tani presim projekt propozimet tuaja për vitin buxhetor 2025.

## 2. Diskutimi i hapur

**Sherif Berisha – Këshilltar Komunal ( ky pjesëmarrës nuk pranoi të nënshkruhet tek lista e pjesëmarrësve):** Dua të bëj një pyetje, se a keni planifikuar të shtoni staf?

**Lindita Ballazhi:** Po, kemi pranifikuar staf, por ky është planifikim fillesatër i buxhetit, do të shpëhim se sa na aprovohet nga Departamenti i Buxhetit, gjegjësisht nga Ministria e Punëve dhe Transfereve, ku i kemi pasur 4 pozita në Drejtorinë e Bujqësisë, Pjlltarisë dhe Zhvillimit Rural të cilat kanë kaluar në Agjencionin Pyjor të Kosovës , mirëpo ato 4 pozita na kanë mbetur neve në administratën komunitare ose në drejtorinë përkatëse, dhe kemi shikuar që këto pozita t'i planifikojmë me staf për të cilat ne kemi nevojë si komunitar.

**Shefket Lusnjani – Administrator i fshatit Gorancë (Kryetar i Shoqatës së Pensionerëve):** Po ju drejtohem me një kërkesë si administrator i fshatit Gorancë, lidhur me rrugën e ByPass-it se kur e planifikoni me e rregullu, në 2025, në 2026 apo në 2027, ne duam ta dimë konkretisht se kur. Si dhe nëse veç do të punohet te Bypass, a ka me u bo shpronësimi i pronës, pak a shumë si ka me qenë procesi? Pyetja tjetër ka të bëjë me rrugën “E shemta”, me këtë pyetje po i drejtohem Visar Hasallarit meqë është prezent këtu, a keni ndonjë informatë se çka ka me u bo aty sepse rreziku vazhdon me qenë për krejt ata që e kalojnë atë udhë.

**Nexhmedin Daci – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje e Mjedisit:** Ne e kemi fut në planifikime për vitin 2025, mirëpo ende nuk e kemi hartu projektin, edhe pse financiarisht jemi shumë të kufizim, vetëm në qoftëse del ndonjë donacion. Kemi tentu edhe me të Ministrisë së Infrastrukturës, ka premtime, por se a realizohen, nuk e dimë. Kurse lidhur me shpronësimet, nuk kam për momentin ndonjë informatë, po sa e dimë ma herët banorët kanë dhanë pëlqim për me u ndërto ai ByPass, dhe nëse ata kërkojnë shpronësim, ka me qenë problem.

**Visar Hasallari – Gazetar në Kallxo.com dhe kryetar i KVRL Hani i Elezit:** Lidhur me pyetjen për te rruga “E shemta” , informatat e fundit që i ekmi është që ai projekt ka dështu, ka pas disa probleme, si rritja e çmimeve pas pandemisë. Ne si BIRN Kosova kemi bo



hulumtim për këtë pjesë, dhe sipas bisedave me zv.Ministrin, kah fundi i korrikut do të fillojnë punimet atje, sepse janë tu e bo një hartim të projektit të përgjithshëm, si dhe gjithashtu diku 49% e shpenzimeve, pagesave të situacioneve i kanë kry ndaj operatorit që e ka përfitu tenderin, e tash ka mbetë për qindja tjetër. Poashtu sipas informacioneve që kemi, kanë fillu ngritja e aktakuzave nga Prokuroria Themelore ndaj disa zyrtarëve të ministrisë, të cilët kanë nënshkruar situacion të pagesave për punë që ende s'kanë përfunduar. Ne jemi duke vazhdu kontaktet me kompanin që e ka përfitu tenderin dhe me Ministrinë, dhe nëse ka diçka do të avzhdojmë tutje.

**Refet Kalisi – Këshilltar Komunal:** Kam disa kërkesa për Han të Elezit: 1. për me e bo rrymën nëntokësore në Han të Elezit, prej Stacionit Policor te Stacioni i trenit, te ndërtesat dhe te shkollat; 2. trotuaret në Han të Elezit janë dëmtu, ku nuk është investu kurgjo, as edhe një kubëz nuk është vnu, këtu kërkoj me u shtru kubëza të reja dhe jo me u bo riparim; 3. nxemja në komunën e Hanit të Elezit me ju bo me pompë termike.

**Lindita Ballazhi:** Kërkesat janë shumë të mira, ndoshta drejtori mund të ketë përgjigje më të plotë për to, mirëpo sa i përket rrymës, nuk di se sa është në kompetencë të komunës me u realizu kjo; për rregullimin e trotuareve ne i kemi në listën e projekteve kapitale për vitin 2025.

**Ahmet Krasniqi – drejtor i SHFMU “Kështjella e Diturisë” - Paldenicë:** Unë i shikova listën e projekteve dhe pash se nuk qenka shtu rregullimi i prrockave në fshatin Paldenicë. Këtë çështje e kam ngrit prej disa viteve sepse prrockat kështu qiç janë shkaktojnë shumë probleme. Në Paldenicë janë dy prroje të mdhaja të cilat janë diku 8 metra të gjana, dhe kur bie shi, niveli i ujit rritet shumë dhe hyn nëpër shpija që janë afër. Propozoj që me u fut si projekte për vitin e ardhshëm.

**Lindita Ballazhi:** Ne e marrim si rekomandim kërkesën tuaj dhe lidhur me të do të njoftoheni përmes raportit të këtij dëgjimi buxhetor, por projektet që ne i fusim në draft , ajo duhet të miratohet nga ansambleja komunale.

**Shefket Lusnjani:** Po ju drejtohem tash si Kryetar i Shoqatës së Pensionerëve, ku e kam kërkesë të vazhdueshme nga ata, ku i kemi 106 pensionista të pleqnisë dhe 160 pensionista kontributdhënës. Shoqata gjithsej i ka 400 pensionista. A ka mundësi që komuna me nda buxhet për këtë kategori , spaku për një pjesë prej tyre që e kanë kushtet më të vështira dhe e kanë ma t'nevojshme me u trajtu në banjë diku, sepse kta pensionistët kontributdhënës gati krejt janë kanë punëtorë të Sharrcemit, dhe me mujt që ju si komunë me bashkëpunu me Sharrcemin për me ju dal krah kësaj kategoria.

**Sherif Berisha:** Propozoj me nda mjete për ujë të pijshëm; propozoj me i hjek të gjitha gypat që janë me azbest, si dhe pjesa e gypave që janë prej te shpia e Afet Ramukës deri poshtë me u bo ndërrimi komplet i gypave kryesor; kam pa një projekt prej sportistave për fushë sporti, është mirë komuna me pas qasje në këtë drejtim.

**Hyrijete Isufi – Këshilltare Komunale:** Po ndërlidhem te pjesa e trotuareve, për me e plotësu: që nëse preken apo hapen trotuaret, fillimisht duhet bërë një projekt për kanalizim.

**Habib Thaçi – banor në Lagjen e Re (mësimdhënës në SHFMU “Kështjella e Diturisë”)**

- **Paldenicë:** Po ju drejtohem me disa pyetje: 1. Cilat janë prioritete kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor, pra për ta rritur buxhetin? ; 2. Te bujqësia, ku janë ndarë vetëm 27 mijë €, kisha pas një sugjerim që me u rrit kapaciteti i shumë, për shkak se bujqësia është një nga çështjet kryesore për zhvillimin e këtij qyteti. 3. Pyetja tjetër ka të bëjë me shtimin e kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re, kisha dashtë me dit se si planifikoni ta bëni shtimin e kapacitetit. 4. E kishit paraparë rregullimin e rezervuarit të fshatit Seçishtë por në vitin 2026-2027, duke e dit që uji është prioritet, pse nuk është në vitin 2025. 5. Një propozim për kategorinë e shpenzimeve kapitale , për shkollat e vogla me u paraparë furnizimi me klima dhe largimi i drunjëve për nxemje nëpër shkolla.

**Lindita Ballazhi:** Prioritete kryesore për ta rritur buxhetin ishte pyetja e parë, ku në Kornizën Afatmesme Buxhetore janë të renditura të gjitha objektivat e Kryetarit , si dhe veprimi për t'i arritur ato. Fatkeqësisht nuk e kemi te ky material por do të jetë i publikuar si dokument, ku disa prej objektivave janë përmbushura, disa janë pjesërisht të përmbushura dhe disa të tjera që pritet të fillojnë së realizuari. për pyetjen e dytë, lidhur me buxhetin e ndarë për bujqësinë, pavarësisht që e dimës e bujqësia është një sektori i rëndësishëm, mirëpo e dini se buxheti komunal është shumë i kufizuar dhe duhet që të gjithë sektorët të preken ngapak. Ndërsapër furnizim me klima nëpër shkolla, ky projekt mund të bëhet nga kategoria Mallara dhe Shërbime, mirëpo duhen parë mundësitë buxhetore, por e marrim si rekomandim. Për pyetjet tjera, mund të përgjigjen drejtorët përkatës.

**Abdurraman Bushi – drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:** Lidhur me propozimin për rritjen e buxhetit nëbujqësi, ju rikujtoj se vitin e parë i kemi pas 11,500 €, ndërsa këtë vit e kemi rritur në 16,000 € ku jemi përqendru në serra dhe në marrëveshjen që kemi pas me Islamic Relief Kosova, ndërsa vitin e ardhshëm e kemi bletarinë dhe pentarinë, dy sektorë që do të fokusohemi ma shumë dhe vetëm për ta i kemi ndarë 10 mijë €, pra vit pas viti buxheti në bujqësi po shkon duke u rrit.

**Arsim Dernjani – drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë:** Lidhur me pyetjen tuaj për rritjen e kapacitetit të ujit, siç e dini në mbikqyrje e ka marr Bifurkacioni, normalisht ne vazhdojmë të jemi pjesë e procesit, mirëpo menaxhimin tashmë e ka Bifurkacioni. Ndërsa sa i përket rezervuarit në Seçishtë, normalisht duhet pasur parasysh buxheti i limituar dhe i shpërndarë edhe në drejtori tjera, kaq ishin mundësitë, mirëpo ne e marrim si rekomandim me e vendos për vitin 2025.

**Halim Ballazhi – banor i Lagjes së Re (bletar dhe fermer në Puset e Nikës):** Po flas për Puset e Nikës, prej Varrezave të Dëshmorëve e deri te Mahalla te Bravt, krejt shtyllat e KEDS-it janë për toke, e që paraqesin rrezik për gjithkan. Unë kam bo kërkesë te ata privatisht, mirëpo nuk po i marrin parasysh kërkesat private. A do të ishte mundësia që ju si Komunë me i thirr ata dhe me e bo këtë kërkesë që me ardh me i rregullu, para se me ndodh naj fatkeqësi?



**Lindita Ballazhi:** Ne e marrim rekomandimin tuaj dhe do të bëjmë kërkesa te KEDS lidhur me këtë çështje.

**Fehmi Shkreta – banor i fshatit Seçishtë:** Si banor i fshatit Seçishtë, shtrohet pyetja, se deri më tani çka është investu në fshatin Seçishtë? Të gjithë ju që jeni kanë në Seçishtë, e dini që nuk është fshat piktoresht por është fshat industrial. Dhe krejt çka është investu aty krejt është në mënyrë vullnetare që ne si banorë i kemi bo, mirëpo më nuk është investu kurgjo. Edhe nëse dojmë me dal me ecë, si shëtitje nëpër fshat, s'ke ku me dal prej pluhurit e prej ambientit të ndotur. Një nga problemet është furnizimi me ujë, ku krejt çka kemi pas të mbjella kanë mbet pa ujitje.

**Lindita Ballazhi:** Lidhur me pyetjen tuaj se çka është investu në Seçishtë, ne si ekzekutiv vitin e kaluar e kemi realizuar projektin e aneksit të urës së Seçishtës në bashkëpunim me Qeverinë Japoneze, si dhe rregullimi i kanalit të hapur në vendin e quajtur Lloka, gjithashtu është investu edhe nëpër shkolla por që drejtoritë kanë sqarimet më të mira se sa vetëm sqarimet financiare që mund të jap unë. Duke pasur parasysh një buxhet prej 500 mijë € me nevojat që i ka kjo komunë, është shumë buxhet i limituar, me aq sa ka pas mundësi janë prekur të gjitha lokacionet e Komunës.

**Mevludin Kuka – administrator në fshatin Seçishtë:** Ajo çka du të paraqes, lidhur me çështjen e bujqësisë, siç e thatë edhe ju drejtoreshë, projekti i kanalit të hapur i Llokës i cili ka qenë projekt i shumë kërkuar është realizu për gjysëm, sepse ai nuk funksionon dhe do të ishte mirë që të punohet për me u funksionalizu ky kanal. E kemi propozu për vitin 2024 rrugën e quajtur “Nën breg”, që me vazhdu me u realizu e mos me u vendos në vitet tjera e me u zgjat, ne e kemi diskutu edhe me drejtorin dhe uroj që me u marrë parasysh këto propozime.

**Nexhmedin Daci:** Propozimet e juaja ne mundemi me i marr dhe i fusim në listën e projekteve, mirëpo duhet edhe miratimi i Kuvendit për me u fut në listë dhe me u punu tek ato projekte. Por kryesorja është çështja e buxhetit, duhet pas buxhet të mjaftueshëm që me mujt me i prek projektet, te disa kërkojnë punë shtesë. Ne absolut i vendosim projektet e propozuara, por ato që janë ma me prioritet kalojnë, dhe pastaj varet nga Kuvendi se a i miraton apo jo ato që ne i dërgojmë apo i ndryshon. Projekti i rrugës nën breg është për vitin 2024, mjetet janë ndarë dhe do të realizohet.

**Arsim Dernjani:** Projekti i kanalit të hapur në Lloka aq ka qenë i planifikum, por për me bo atë vijën me depërtu uji në livadhe, duhet me u bo me iniciativën e administratorit, këto janë edhe fjalët e punëkryesit i cili edhe pse kanë kalu 1 vit prej realizimit të projektit, ai zotohet për me e kry hapjen e asaj vijës, por duhet bo me iniciativën e administratorit. Kur të vijë punëkryesit i kanalit këto ditë, ne mundemi me ardh bashkërisht edhe me pa qysh me rregullu.

**Bunjamin Berisha – përfaqësues i KM “Sharri” dhe mësimdhënës në SHFMU “Kështjella e Diturisë” - Paldenicë:** Kam tre pyetje: 1. Lidhur me planifikimin urban dhe mjedisi, te numri rendor 24 përmendet shpronësimi i fabrikës së ujit, shtëpia e kulturës, oborri i komunës, e veç tjerash është edhe stadiumi i qytetit “Suad Brava”, nëse mundet një informacion shtesë lidhur me këtë ; 2. E dyta ka të bëjë me drejtorinë e kulturës dhe sportit, te

projekti i paraparë për rregullimin e terreneve sportive në shtëpinë e kulturës, si dhe në shkollat fillore, nëse mundet një sqarim se a është krijimi i terreneve të reja apo rregullimi i atyre ekzistuese, si dhe çka planifikohet me u investu te shtëpia e kulturës në këtë drejtim ; 3. Për drejtorin Arsim, çështja e qenve endacakë është rreziku më i amdh në qytetin tonë, çka keni paraparë në këtë drejtim.

**Nexhmedin Daci:** Lidhur me shpronësimet te lokacionet e përmendura, do të lryhen shpronësimet sepse janë parcela në emër të ATK-së, disa në emër të Sharrcemit, ne i kemi dokumentacionet apo elaboratet e shpronësimit gati qysh vitin e kalum, i kemi dërgu në Ministri që t'i kalojnë në Qeveri, pra që këto proan të kalojnë si pronë komunale.

**Arbenita Bajramaliu – drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport:** Lidhur me pyetjen për terrenet sportive, është një gabim teknik ku është shënu edhe Shtëpia e Kulturës, por rregullimet do të bëhen vetëm në shkollat fillore ekzistuese.

**Arsim Dernjani:** Lidhur me çështjen e qenve endacakë, jemi në bisedime me nivelin qendror, sepse është problem që e ka marrë përsipër niveli qendror , por momentalisht nuk kemi asnjë zgjidhje sepse nuk kemi kapacitet, ne mundemi me dërgu shkresë në nivel qendror, fotografi e diçka të tillë, por vetëm kaq kemi mundësi.

**Hysni Krasniqi:** 1. Te çështja e kanalizimit për fshatin Paldenicë, kur ka reshje të mëdha, krejt hyn nëpër shpija, aty ka edhe aksidente që janë shkaktu vitin e kalum se ka dal rrjedha në rrugë, a ka mundësi me marr një vendim me dal me i pastru ato, sepse aty është një krue dhe kanë gjujt lloj lloj mbeturine edhe mo kërkush nuk i ka hjekën . Faleminderit që keni rregullu kanalizimin, por me caktu dikën që me e lanë përgjegjës që avzhdimisht me e mirëmbajtë atë, e jo me e lanë me u grumbullu mbeturina aty e me u nxanë e me na shkaktu mandej probleme; 2. Krejt ne që kemi ujë të pijshëm, e kemi prej puseve, dhe me u ndal rryma ne mbesim edhe pa ujë. Ne s'kemi shpresë se ka me u rregullu najherë puna e ujit, por jemi të shqetësuar, sepse kush furnizohet me ujë të Gilloboçicës ose uji që vjen prej maleve të Sharrit krejt derdhet në Lepenc.

**Faruk Berisha – drejtor i SHFMU “Veli Ballazhi” – Gorancë:** Si drejtor i SHFMU “Veli Ballazhi” në Gorancë kam dy propozime: 1. propozoj që me u vendos nxemjet qendrore dhe rrethojat dhe 2. Nuk ka rëndësi se në cilin vit, por kisha propozu me u fut si kod buxhetor në listën e projekteve edhe rrafshimi i sallës sportive, apo nivelizimi i sallës sportive të jashtme me rrugën e fshatit, sepse kur është bo ai terren sportiv, ka mbet pak jashtë funksionit edhe me rregullimin e fushës sportive të brendshme, ngjitur me objektin e shkollës.

**Lindita Ballazhi:** Ne i marrim këto propozime dhe për to do të njoftoheni përmes raportit të dëgjimeve që do të publikohet.

**Sherif Berisha:** Ne e kemi rregulloren komunale për tarifa , unë kërkoj që të zbatohet kjo edhe për kabllot që janë në ajër prej televizioneve të ndryshme , ne si qytetarë po kemi probleme dhe s'po dimë ku me u orientu. Gjithashtu di që është përgatit një projekt nga drejtoresha



Majlinda për në fshatin Gorancë, nuk e pash tek lista që është paraparë me u rregullu në vitet 2025-2027. Qëndroj mbrapa projektit të Bypass-it, është mirë me u përgatit.

**Habib Thaçi:** Tabelat informuese në Han të Elezit janë në nivel të lartësisë shumë të ulët, dhe po shkaktojnë problem te qytetarët , kisha sugjeru që herën tjetër kur të rregullohen le të jenë në nivel ma t'naltë.

**Shefket Lusnjani:** A ka mundësi që ju si Komunë që te rruga “ E shemta” me e shtru me zhavor s'paku?

**Arsim Dernjani:** Edhe ma herët kemi qit zhavor te ajo rrugë, besoj se edhe këtë herë mundemi me e kry këtë shërbim.

**Nexhmedin Fida – komandant i sektorit të zjarrëfikësve:** Drejtoria e Shërbimeve Publike mund të jetë e vetmja drejtori në nivel shteti e cila buxhetin e saj nuk e ka të specifikum për sektorët, shembull për emergjencë, për qentë endacakë, e fatkeqësi natyrore e të tjera. Kërkesën e kam direkt për shërbimin e zjarrëfikësve, që për vitin 2025, unë si komandant i zjarrëfikësave, s'paku du ta di se buxhet sa janë të dedikume për ne, pavarësisht a janë 500 €, 1 mijë € apo 10 mijë €. Për shërbime të ndryshme që kemi në sektorin tonë, drejtoria gjithmonë thotë se nuk ka buxhet, përveç që na ndihmon në derivate, dhe produkte të higjienës, kurse prej nivelit qendror nuk kemi asgjë, atyne veç se ju raportojmë. Ne vetëm duam ta dimë se prej nivelit komunal sa buxhet janë për sektorin e zjarrëfikësave. Sepse nëse neve na ndahen mjete në sektorin tonë, dhe kur na prishet kamioni, ne e rregullojmë sepse kemi mjete të dedikume, e jo me na mbetë kamioni jofunksional qe 3 muaj.

**Arsim Dernjani:** Sivjet kemi rrit buxhetin pak ma shumë te kategoria mallra dhe shërbime, dhe jemi pak ma mirë me buxhet, ju mjafton ta parashtroni kërkesën tuaj.

**Lindita Ballazhi:** Ne e marrim parasysh rekomandimin tuaj për sektorin e zjarrëfikësve, dhe paraqitjen e sfidave që i hasni. Sa i përket buxhetit i cili është ndarë për sektorin e zjarrëfikësave, ajo shkon me program buxhetor në kuadër të shërbimeve publike, ende nuk është e delegume në një sektor tjetër, ashtu siç rojet e pyllit kanë kalu në Agjencionin Pyjor të Kosovës, edhe ju jeni ende nën udhëheqjen e drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë, dhe planifikimi i buxhetit bëhet bashkërisht me atë kod buxhetor apo drejtori përkatëse. Gjatë hartimit të planit të drejtorisë, ju mundeni bashkërisht ta hartoni atë plan dhe t'i paraqisni ato punë apo aktivitetet tuaja gjatë vitit të ardhshëm.

**Fehmi Shkreta:** Akisoni që ishte në fshatin Seçishtë për mbjelljen e pishave , a është mundësia me vazhdu si aksion edhe në vjeshtë, sepse tash edhe veç kanë fillu me mbi.

**Abdurraman Bushi:** Sa i përket pishave, na është pas premtu që kanë me na i sjellë në muajin janar, mirëpo nuk na i kanë sjellë. Ne kemi bisedu edhe me Ministrinë, në mars ua kemi përcjellë kërkesën dhe jemi në pritje të një përgjigjje. Ndërsa lidhje me sigurimin e ujit për ujitje, Komuna e ka problem këtë pjesë, por nëse ka ndonjë burim të afërt të ujit dhe na e japin atë shërbim, sepse kapacitete komuna nuk ka me ofru ujitje për pishat.



**Visar Hasallari:** Kërkesat e mia janë si në vijim: 1. Meqë jemi në muajin e çlirimit, me pa mundësinë e vendosjes së scan kodeve të Varrezat e Dëshmorëve, ku tregohet historia e secilit dëshmor e që vizitorët kishin me pas ma lehtë me dit për secilin. 2. Rritja e fondeve për OJQ-të dhe klubeve sportive, e kuptoj se ka kuzifim financiar por është kërkesë e gjithë rrjetit të OJQ-eve, pra duam të dimë se sa do të jetë shuma e dedikuar për subvencione për OJQ-të ; 3. Tek raporti i auditimit social që e kemi pas, ne e kemi nënshkru një marrëveshje me komunës, kërkoj me dit se rekomandimit e atij raporti a janë marrë parasysh dhe a kanë fillu me u zbatu, siç ka qenë vendosja e një çeshmes publike, ëc publike, apo se çka është vendos të bëhet me bunkerët. 4. Si banor i Lagjes së Re, kërkoj që të realizohet një projekt tek pjesa e poshtme e përroit të Lagjes së Re; 5. Një çështje tjetër lidhur me orarin e punës nga operatorët ekonomik, ku veçse është e miratume një Rregullore për orarin e punës, mirëpo kam ankesa nga qytetarët se kjo rregullore s'po zbatohet, veçanërisht gjatë verës, dhe kërkoj që të merren masa nga inspektorët.

**Majlinda Kaloshi –drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm:** Lidhur me scan kodet të Varrezat e Dëshmorëve, ne gjatë vitit 2023 veçse i kemi bërë këto skenime në mënyrë që me pas vizitorët informata sa më të sakta të Hanit të Elezit, është fjala për profilin ekonomik , dhe gjithashtu edhe nëpër kartolina e kemi të skenime kodin dhe është promovu edhe në Panairin Ndërkombëtar në Prishtinë. Tek ideja e scan kodeve të Varrezat e Dëshmorëve veç jemi në implemmentim, e kemi angazhu dikë që me e kry këto shërbim, dhe besoj se shumë shpejt veçse do të realizohet. Te çështja tjetër, te Rregulloorja për subjektet afariste, është një çështje ma delikate, me të cilën përballemi krejt drejtorat për zhvillim ekonomik në nivel vendi, jemi duke tentu me e bërë një Rregullore unifikuese që ka me qenë e njëjtë për të gjithë, normalisht ne përjashtohemi sepse jemi zonë kufitare dhe nuk kemi potenciale zhvillimore të njëjta siç i ka Prishtina apo qytete tjera që nuk janë të kufizume me shtete fqinje. Pra, ne jemi tu prit me u bërë ajo rregullore unifikuese, ne me e përditësu atë për qytetin tonë, besoj se do të rregullohet brenda vitit. Te çështja e bunkerëve ne jemi tu punu në këtë çështje dhe besojmë se me to do të krijojmë një potencial të ri të turizmit dhe ruajtjes së trashëgimisë.

**Nexhmedin Daci:** Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit social , ne i kemi parasysh disa, kurse shembull vendosja e një ëc publike unë jam kundër saj, e apra sepse nuk ka mundësi mirëmbajtje dhe me shfaqjen e sëmundjeve ngjitëse, ma shumë do të bëhej dëm kolektiv se sa që do të ishte e dobishme.

**Arbenita Bajramaliu:** Lidhur me ngritjen e fondeve për OJQ-të , vitin e ardhshëm për herë të parë subvencionet do të ndahen drejtëpërdrejtë nga DKRS, janë në shumë prej 18 mijë €, kurse pjesa tjetër do të mbështetet nga Zyra e Kryetarit, pra me ndarjen e subvencioneve nga zyra e Kryetarit në një drejtori përkatëse në tjetrën, rritet mundësia edhe për ngritjen e fondeve të dedikuara në këtë rast për OJQ-të, vit pas viti. Deri më tani nga Zyra e Kryetarit janë dedikuar 25 mijë € për subvencionet në kulturë, rini dhe sport, ndërsa nga vitit tjetër, subvencionet do të rriten dhe do të ndahen edhe për OJQ tjera e jo vetëm për kulturë, rini e sport.



**Lindita Ballazhi:** Aktualisht subvencione totale i kemi 113 mijë , dhe me rritjen e të hyrave, planifikojmë që tek subvencionet të planifikohen deri në 143 mijë €, prandaj do të ketë rritje edhe tek subvencionet për OJQ-të nga DKRS-ja. Por se sa do të jenë të dedikuara veçanërisht për kulturë, rini dhe sport, ne nuk e kemi bërë akoma ndarjen, ne do t'i marrim rekomandimet tuaja por edhe planifikimet tona, do t'i paraqesim në KPF dhe Kuvend Komunal, e më pas varet nga Kuvendi Komunal se a e aprovon apo jo planin që ne e paraqesim para tyre. Pra faza e buxhetit fillon këtu dhe përfundon në janar të vitit të ardhshëm kur do të dalë gjithçka në Ligj të Buxhetit. Momentalisht mund të shihni se janë të ndara 143 mijë € në kategorinë subvencione dhe transfere, ne do ta hartojmë planin e ndarjes së subvencioneve dhe ai plan do të publikohet edhe në ëbfaqen e komunës dhe do të dorëzohet edhe në zyrën e kryeministrit, dhe tek ai plan do ta kemi shumë të qartë se cila drejtori sa e ka financimin në subevncione dhe se çka do të bëjë me ato subvencione.


**Mevludin Kuka:** Nëse veç e keni pa, në rrugën magjistrale është prish tabela digjitale shkak i reshjeve të breshërit, do të ishte mirë që me u rregullu ajo, sepse ka mbetë shumë keq. Si dhe çështja tjetër për DSHMS-në, lidhur me këtë doktorin problematik, çka keni marrë masa ndaj tij?

**Kimete Kuka – Hasallari – drejtore për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:** Mrenda QKMF-së është komisioni diciplinor sepse kemi marrë parasysh shqetësimet tuaja, dhe ata kanë dërgu një raport tek Islamiku.

**Lindita Ballazhi:** Ne kemi mbajtë procesverbal të këtij debati dhe të gjitha propozime tuaja do të shqyrtohen sërish. Nëse dikush ka ndonjë pyetje tjetër apo propozim, mundeni edhe të më drejtorheni në emailin tim [Lindita.ballazhi@rks-gov.net](mailto:Lindita.ballazhi@rks-gov.net) apo edhe kërkesat tuaja ti dërgoni fizikisht tek Qendra për Shërbim me Qytetarë, e më pas ne do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkesat, sugjerimet, rekomandimet dhe propozimet tuaja, si ato gjatë këtij debati, ashtu edhe ato përmes emailit dhe përmes dërgimit te QSHQ. Nëse nuk ka tjetër diskutim apo propozim, e konsideroj të mbyllur debatin publik.

Debati publik përfundoi në orën 12:15.









REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR PËR KORNIZËN  
AFATMESME BUXHETORE 2025-2027

Lokacioni: Salla e Konferencave në Qendrën Kulturore "Imri Curri"

Data: 13.06.2024

Ora: 11:00

NR	EMRI DHE MBIEMRI	NUMRI KONTAKTUES	NËNSHKRIMI
1	ALI AXHANI	[REDACTED]	[Signature]
2	ARBANTA BAJRAMALIU	[REDACTED]	[Signature]
3	Yafije Axhami	[REDACTED]	[Signature]
4	ARSIM DERNJANI	[REDACTED]	[Signature]
5	ARDITA BUKOLLI KALISI	[REDACTED]	[Signature]
6	SAHADETE ZHARKU KALISI	[REDACTED]	S. Kuf.
7	Betime Dernjani	[REDACTED]	[Signature]
8	Amir Dernjani	[REDACTED]	[Signature]
9	Jewer HURERO	[REDACTED]	[Signature]
10	REAHMAN BUSHI	[REDACTED]	[Signature]
11	SARA BERISHA	[REDACTED]	[Signature]
12	Muhareze Pozari	[REDACTED]	[Signature]
13	HYRINETE ISUFI	[REDACTED]	H. Isuf

41 Florim Shkreta

[Redacted]

Dupli  
Amir

42 NEXHMEJIN FIDA

[Redacted]

14	SEVINE BAJRAMI	[Redacted]	[Signature]
15	Alban Loxi	[Redacted]	[Signature]
16	Manduh Braza	[Redacted]	[Signature]
17	Majlinda KALONI	[Redacted]	[Signature]
18	Vison Hoxhallari	[Redacted]	[Signature]
19	[Redacted]	[Redacted]	[Signature]
20	Rashid Lusnjani	[Redacted]	[Signature]
21	Egzona Braza	[Redacted]	[Signature]
22	Naim-sheli-Romulo	[Redacted]	[Signature]
23	Mervude Ballazhi	[Redacted]	[Signature]
24	Ahmet Krasniqi	[Redacted]	[Signature]
25	HABIB THAQI	[Redacted]	[Signature]
26	Benjamin Benisha	[Redacted]	[Signature]
27	Mervudin Kuka	[Redacted]	[Signature]
28	Homere Kuka Jasallari	[Redacted]	[Signature]
29	Abdunaman DUSTRI	[Redacted]	[Signature]
30	Nexherdi Dini	[Redacted]	[Signature]
31	Rezet Kolici	[Redacted]	[Signature]
32	FATMIR WTA QAMA	[Redacted]	[Signature]
33	FRUK BARIKA	[Redacted]	[Signature]
34	ROZART Mehmed	[Redacted]	[Signature]
35	AMIK QASANI	[Redacted]	[Signature]

36. N Hefajit Dardajini

[Redacted]

[Signature]

37. HYSNI KRASNIQI

38. Fehmi Shkreta

39. LIRIDONA BALLAZHI

40. ASAN SHKRETA

41. LINDITA BALLAZHI

Adus  
Ballazhi